



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 4  
06.06.2016

NR. VENDIMI 9  
09.03.2017

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Liljana BAKU – Kryesuese**

**Fran PRENDI – Anëtar**

**Luan HASNEZIRI – Anëtar**

asistuar nga sekretare seance **Olta SINANAJ**, sot në datë 9.3.2017, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e çështjes me Nr. Regjistri, që i përket palëve:

**PADITËSE:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurore Sonila Muhametaj.

**TË PADITUR:** .

1. N.G, lindur në Lushnjë dhe banuese në Durrës, Lagjja Nr.xx, Spitallë, Rruga “XXXXXX”, identifikuar me dokumentin identifikues ID, me Nr.XXXXXX, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr. 250 Rep, Nr.243 Kol datë 30.06.2016, nga Av. J. Q. me Nr.Liçense XXXX Nr. Nipti X XXXXXXX X, anetare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

2. S.G, banues në Durrës, Lagjja Nr. X, Spitallë, Rruga “XXXX”, përfaqësuar, sipas Prokurës së Posaçme Nr.250 Rep, Nr.243 Kol datë 30.06.2016, nga Av.J. Q. me Nr.Liçense XXXX Nr.Nipti X XXXXXXXXX X, anetare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**PERSONA TË TRETË:**

1.F.G, i datëlindjes XXXXX, lindur në Durrës dhe banues në Lagjen Nr.X, Spitallë, Durrës, me shtetësi shqiptare dhe italiane, me arsim të lartë, me profesion topograf, me gjendje civile i divorcuar, me gjendje gjyqësore, i padënuar, identifikuar me dokumentin e identifikimit ID me Nr.XXXXXX, përfaqësuar nga Av. J.

Q. , zgjedhur me deklaram në seancën gjyqësore, të datës 28.07.2016.

2.I.M, i datëlindjes XXXXX, lindur dhe banues në Durrës, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile beqar, identifikuar me dokumentin e identifikimit ID me Nr.XXXXXX, përfaqësuar nga Av. J. Q. , zgjedhur me deklaram në seancën gjyqësore, të datës 26.10.2016.

3.B.M (G), , i datëlindjes... lindur dhe banues në Durrës, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile beqar, shpallur mosgjetya me vendim gjykate, përfaqësuar nga Av. J. Q. , zgjedhur nga të afërmit e tij me deklaram në seancë.

4.SH.H, i datëlindjes XXXXX, lindur dhe banues në fshatin XXXX Kavajë, me arsim tetë klasë, me profesion punëtor ndërtimi, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, identifikuar me dokumentin e identifikimit ID me Nr.XXXXXX, përfaqësuar nga Av.J. Q. , zgjedhur me deklaram në seancën gjyqësore të datës 28.07.2016.

**OBJEKTI:** Konfiskim i pasurive të mëposhtme:

1. Ndërtesë katër katëshe, e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX me numër pasurie 5/32, e cila ka një sipërfaqe prej 1 810 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, që është në proces legalizimi në emër të shtetasit S.G;

2. Apartament banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me numër pasurie xx/xxx+x-xx, vol xx, faqe xxx, zona kadastrale XXXXX, Durrës, rregjistruar në emër të shtetases N.G;

3. Lokal, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me adresë në lagje nr. X, Rr: “XXXX”, me numër pasurie xx/xxx- xxx, zona kadastrale XXXX, volumi xx, daqe xxx, në emër të shtetases N.G

4. Shumë lekësh prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat dhe analizoi në tërësi rrethanat e çështjes, dëgjoji pretendimet përfundimtare të palëve në të cilat u kërkua:

Prokurorja kërkoi konfiskimin e pasurive sipas objekt të kërkesës;

Mbrojtësja e personave të paditur dhe personave të tretë kërkoi rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova e ligj

## **V Ë R E N**

1. Në datë 12.10.2015, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda,Tiranë, regjistroi procedimi pasuror Nr. 11 në ngarkim të shtetasit B.G. Regjistrimi i këtij procedimi u bë mbi bazën e materialit procedural, të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Durrës (fashikulli i hetimit i dërguar me Shkresën Nr.495/2013), në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 106 datë 18.05.2010, “Për bashkërendimin e raporteve mes prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë për Krime të Rënda” dhe në zbatim të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009. Nga përmbajtja e këtij materiali rezultoi se, në datë 21.03.2013, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, u regjistrua procedimi penal Nr. 495/2013, për veprën penale të: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, e parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal.

**2.** Regjistrimi i procedimit në Prokurorinë Durrës u bë, mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, nga i cili rezultonte se, shtetasja N.G kishte kryer dy transaksione me vlerë të përgjithshme 265 000 euro, duke paraqitur si burim krijimi kursimet vetjake; familja G. kishte në proces legalizimi, një objekt katër katësh, të ndërtuar në Durrës, në periudhën e viteve 1993-2000; në vitin 2006 kishin blerë një apartament në Durrës, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>; anëtarët e familjes G, nuk ushtronin aktivitet financiar; nga të dhënat e dërguara nga Zyra e Interforcës në DPPSH Tiranë, rezultonte se, në shtetin Italian, në vitin 2001 shtetasja N.G, ishte sinjalizuar për posedim të sendeve të vjedhura dhe fallsifikim, djali i saj, B.G, po në këtë shtet, në kohë të ndryshme, pas vitit 2001, ishte arrestuar për shkelje të ligjit mbi lëndët narkotike, vjedhje dhe vjedhje me dhunë.

**3.** Në seancën gjyqësore të datës 28.07.2016, gjykata, bazuar në nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 22 pika 3 të Ligjit të posaçëm Nr. 10 192, datë 3.12.2009, thirri me cilësinë e personave të tretë në gjykim, shtetasit F.G dhe SH.H, meqënëse, nga përfaqësuesja e palës së paditur u pretendua se, në krijimin e pronësisë së objekteve të konfiskimit, kishin kontribuar edhe këta shtetas, duke kërkuar njëkohësisht, marrjen e provave që njoftonin të ardhurat e siguruara prej tyre. Të paraqitur personalisht në seancën gjyqësore, të datës 28.07.2016, dy personat e tretë zgjodhën si përfaqësuese të tyre Av. J. Q. dhe gjykata, bazuar në nenin 96 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me nenin 22 pika 1 të ligjit të posaçës, legjitimoi avokaten e zgjedhur, si përfaqësuese të posaçme të personave të tretë.

**4.** Më të njëjtën bazë ligjore, gjykata disponoi edhe në seancën gjyqësore të datës 27.09.2016, duke thirrur me cilësinë e personit të tretë shtetasit B.M (G) dhe I.M, meqënëse, u pretendua nga përfaqësuesja e palës së paditur se, këta persona kishin kontribuar në krijimin e pasurive objekt konfiskimi, duke paraqitur edhe prova mbi të ardhura e siguruara prej tyre. Personi i tretë I.M, i paraqitur personalisht në seancën gjyqësore, të datës 26.10.2016, emëroi si përfaqësuese të posaçme të tij Av. J. Q. , e cila bazuar në nenin 96 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 22 pika 1 të ligjit të posaçëm, u legjitimua si përfaqësuese e tij.

**5.** Për njoftimin e personit të tretë B.M (Gorgeja), gjykata urdhëroi njoftimin e tij në adresën e banimit, nëpërmjet shërbimit postar dhe në gjykatë mbërriti kopjo e aktit të njoftimit të tij, me nënshkrimin e shtetasit I.M, në Rubrikën “Marrësi”. Gjithashtu, gjykata urdhëroi njoftimin e tij edhe nëpërmjet policisë gjyqësore, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës. Në zbatim të urdhërit të gjykatës, mbërriti Shkresa Nr.1041/1 Prot, datë

18.10.2016, e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, nga e cila rezultoi se, njoftimi i shtetasit B.M, nuk u krye pasi, nga kërkimet dhe verifikimet e kryera, rezultoi se, ai ndodhej jashtë shtetit. Bashkëlidhur shkresës, u dërgua Raporti i Sistemit TIMS, për hyrje-daljet e shtetasit B.M, nga i cili rezultoi se, ai kishte dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, në datë 14.03.2016 dhe nuk kishte hyrje pas kësaj date.

**6.** Për sa më sipër, gjykata, bazuar në nenin 22 pika 2 të ligjit të posaçëm, vendosi nxjerrjen e vendimit të mosgjetjes, për personin e tretë B.M (G), meqënëse, nuk u bë e mundur gjetja dhe njoftimi i tij, për shkak të largimit jashtë shtetit. Me të njëjtën bazën ligjore, gjykata vendosi që, interesat e personit të tretë B.M, të përfaqësoheshin nga Av. J. Q. , e zgjedhur si e tillë nga dy të afërmit e personit të tretë, nëna N.G dhe vëllai I.M, ndodhur para faktit se, midis interesave të palës së paditur N. e S.G dhe personave të tretë I.M dhe B.G, bijtë e tyre, nuk kishte papajtueshmëri interesash.

**7.** Gjukata përpara se, të shprehet në lidhje me pretendimet e palëve dhe kërkimet e tyre, në lidhje me objektin e gjykimit, çmon të parashtrijë, në mënyrë të përmbledhur, natyrën e gjykimit me karakter “pasuror” ose “in rem”, i cili parashikohet nga ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Sqarimi i natyrës së këtij gjykimi, përbën një moment shumë të rëndësishëm, në vlerësim të kësaj gjykate, për të kuptuar nëse, pretendimet dhe kërkimet që palët paraqitën në këtë gjykim, janë të bazuara në prova dhe ligj.

**8.** Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitave të ligjit të mësipërm, rezulton që, në këtë gjykim, me karaktert pasuror ose “in rem”, në ndryshim nga gjykimi penal ose “in personam”, (ku barrën e provës për të provuar që i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, e ka prokurori), barra e provës është e ndarë, ndërmjet palëve, paditësit, i cili, në këtë rast është prokurori dhe të paditurit dhe/ose personave të tretë. Në bazë të ligjit të mësipërm, prokurori ka barrën e provës për të provuar që, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie se, i padituri ose personi i tretë, ka marrë pjesë në një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit në fjalë. Nga ana tjetër, i padituri ose personi i tretë, kanë barrën e provës për të provuar që, pasuritë për të cilat kërkohet konfiskimi, kanë patur të ardhura të ligjshme që të justifikojnë pronësinë ose posedimin e tyre ose që nuk ekziston një disnivel i dukshëm, ndërmjet të ardhurave të tyre dhe pasurive që ata zotërojnë ose kanë në posedim.

**9.** Në çështjen në gjykim, bazuar provat e shqyrtuara dhe të analizuara rezultojnë që, objekt i konfiskimit janë, godina katërkatëshe, me sipërfaqe ndërtimi 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, e cila, në kërkesën për gjykim nga prokurori u paraqit si godinë gjashtë katëshe, por që, pas kryerjes së aktit të ekspertimit vlerësues, edhe nga prokurori, në diskutimin përfundimtar u pranua që, ajo është katërkatëshe, godinë e cila është ndërtuar gjatë periudhës së viteve 1993-2000, fakt ky i provuar në bazë të konkluzioneve të aktit të ekspertimit vlerësues, dhe i pranuar edhe nga prokurori në gjykim, godinë që është në proces legalizimi, në emër të të paditurit S.G, një apartament banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në emër të të

paditurës N.G, blerë me datë 24.8.2005, një lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, në emër të të paditurës N.G, blerë me datë 4.3.2005, si dhe një shumë prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh, në emër të të paditurës N.G.

**10.** Duke iu referuar periudhës së kohës kur janë krijuar pasuritë objekt konfiskimi, si dhe duke iu referuar kohës kur, për të paditurit dhe personat e tretë, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie që, kanë kryer një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 e ligjit, gjykata, vlerëson që, nga ana e akuzës, barra e provës që ligji i posaçëm nr. 10 192, datë 3.12.2009, i ngarkon, provohet nga ana e saj, vetëm për pasuritë, një apartament banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në emër të të paditurës N.G, blerë me datë 24.8.2005, një lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, në emër të të paditurës N.G, blerë me datë 4.3.2005, si dhe një shumë prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh, në emër të të paditurës N.G.

**11.** Ndërsa, përsa i përket godinës së banimit katër katëshe, me sipërfaqe ndërtimi 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, e ndërtuar nga të paditurit dhe personat e tretë, në periudhën e viteve 1993-2000, fakt ky i pranuar edhe nga akuza në gjykim, nga ana e saj, nuk u arrit që të provohet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie që, kjo pasuri është fituar nga të paditurit dhe personat e tretë, nga aktiviteti i paligjshëm. Duke iu referuar të gjitha akteve dhe provave të shqyrtuara, të cilat burojnë, kryesisht nga aktet e dërguara me letërporosi nga autoritetet italiane, rezulton që, dyshimet e arsyeshme, të bazuara në indicie për të paditurit dhe personat e tretë, se, ato janë përfshirë në veprimtari kriminale që janë objekt i pikës 1, të nenit 3 të ligjit, ekzistojnë për periudhën vetëm pas vitit 2003, ndërkohë që, godina katërkatëshe, objekt konfiskimi, është ndërtuara në periudhën 1993-2000, para se, për të paditurit dhe personat e tretë, të ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie që, ato kanë kryer një ose disa nga veprat penale të parashikuara nga pika 1, e nenit 3 të ligjit në fjalë.

**12.** Konkretisht, sipas Shkresës, me Nr. UCI/ALB/RF83-4/FR, Nr.1372-k/IProt, datë 01.03.2013, të Zyrës së Interforcës drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bashkëngjitur kësaj shkrese, dokumnetacioni shoqërues, rezulton që, shtetasi B.G, me cilësinë e personit të tretë në këtë gjykim, është arrestuar në flagrancë, në datë 09.12.2004, në Novara për shkelje të ligjit mbi lëndët narkotike; në datë 29.06.2005, ai rezultonte i vendosur në arrest në shtëpi, nga Gjykata në Novara, për shkelje të lgjit mbi lëndët narkoitke; në datë 14.09.2005, i arrestuar në vijim të ekzekutim-vendimit duke u dërguar në Burgun në Alessandria, masë me të cilën u pezullua arresti në shtëpi; në datë 06.07.2006 ai lirohet nga burgun në zbatim të urdhërit të Gjykatës së Apelit Torino, e cila jep masën “Arrest në shtëpi”, për shkelje të ligjit mbi lëndët narkotike; në datë 29.09.2007, nxirret urdhër ekzekutim burgimi nga Zyra për Ekzekutimin e Vendimeve Penale e Gjykatës në Novara, pasi duhet të shlyejë në burg, pjesën e mbetur të dënimit që përfundon në datë 03.12.2012; në datë 19.11.2007, Gjykata e Apelit Torino konfirmon dënimin e Gjykatës në Novara, prej gjashtë vjet burgim dhe 20 000 euro gjobë (dënimi përfundimtar në datë 31.10.2006 për shkelje të ligjit mbi lëndët narkotike); në datë 27.11.2008 i dënuar nga Gjykata në Alessandria me 9 muaj burgim për “arratisje nga arresti shtëpiak”, dënim i

pezulluar dhe përfundimtar nga data 19.12.2009.

**13.** Po në bazë të akteve të letërporosisë, rezulton që, për shtetasin shtetasi B.G, i njohur me emrin I.S, në datë 20.02.2004, është nxjerrë, urdhër ekzekutimi burgimi, lëshuar nga Gjykata në Terni, Itali, pasi duhej të shkyente dënimin prej katër vejt burgim (veprat penale vjedhje dhe vjedhje me dhunë); në datë 09.12.2004 i komunikohet në burg, në vijim të arrestimit për posedim lëndësh narkotike, masa e sigurisë “Arrest në burg”, lëshuar nga Gjykata në Terni, për veprën penale “Vjedhja me dhunë”; në datë 09.08.2005, masa e sigurisë “Arrest në shtëpi” në Novi Ligure, Corso Marengo Nr.183; në datë 14.09.2005, dërgohet në Burgun në Alessandria, në vijim të Vendimit të Gjykatësit Mbikqyrës në Norava; në datë 26.10.2005, rikthehet në “Arrest në shtëpi”; në datë 01.06.2006, H.S alias B.G në vijim të pezullimit të masës së sigurisë “Arrest në shtëpi”, dërgohet në Burgun në Alessandria.

**14.** Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e akuzës, të paraqitur në diskutimin përfundimtar, në faqet 2 dhe 3 të tij, sipas të cilit, për personin e tretë B.G ose B.G, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie që, ai ka kryer një nga veprat penale, të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, duke filluar nga viti 1998, sepse, në bazë të akteve të Letërporosisë, të autoriteteve italiane, të cituara më sipër, është e vertetë që, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie që, ky shtetas, me datë 14.8.1998, të jetë evidentuar për veprën penale të: “Vjedhjes”, si dhe me datë 23.5.200, për veprat penale kundër personit dhe vjedhjes, por, duke iu referuar të gjitha germave të pikës 1 të ligjit në fjalë, rezulton e qartë se, veprat penale të vjedhjes dhe kundër personit, janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të këtij ligji.

**15.** Për këtë arsye, pretendimi i akuzës se, që nga viti 1998, për personin e tretë B.G ose B.G, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, se ka kryer një nga veprat e parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, gjendet i pabazuar, ndërkohë që, provohet se, data fillestare ose më e hershme kur, për këtë shtetas ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie, që ka kryer një nga veprat e parashikuara nga ligji në fjalë, është datë 9.12.2004, datë në të cilën ai, është arrestuar në flagrancë, në Novara, Itali, për shkelje të ligjit “Mbi lëndët narkotike”, ku, kryerja e kësaj vepre, është e parashikuar në germën “ç”, të pikës 1 të nenit 3 të ligjit në fjalë.

**16.** Gjykata vlerëson që, organi i akuzës arriti që të përmbushë pjesën e vet të barrës së provës që, për të paditurit dhe personat e tretë, ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se, kanë kryer një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, vetëm pas datës 9.12.2004, ndërsa, para kësaj date, nuk ekziston asnjë e dhënë që të paditurit të kenë kryer një nga veprat që janë objekt i këtij ligji, pavarësisht se, ata, mund të kenë kryer vepra të tjera penale, duke qenë se, këto vepra nuk përfshihen në objektin e ligjit në fjalë, nuk ndihmojnë akuzën për përmbushjen e barrës së provës që ajo ka në këtë gjykim

**17.** Bazuar në faktin që, pasuria katër katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, është ndërtuar nga të paditurit dhe personat e tretë, në periudhën 1993-200, e cila është një periudhë para se, në ngarkim të tyre të ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara

në indicie që, ato kanë kryer një ose disa nga veprat penale të parashikuara nga ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, kjo pasuri, në bazë të nenit 3, pika 4 e këtij ligji, nuk është objekt i këtij ligji dhe për pasojë, nuk mund të konfiskohet. Kjo dispozitë ligjore parashikon:

**“4. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji”.**

**18.** Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, rezulton se, që të zbatohen dispozitat e këtij ligji edhe për pasuritë që janë vënë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, siç është edhe godina katër katëshe, objekt konfiskimi, duhet të provohet kushti që, ato pasuri të jenë krijuar gjatë përfshirjes së dyshuar të personit, në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji. Në rastin konkret, provohet dhe pranohet edhe nga prokurori dhe të gjithë palët që, pasuria godinë katërkatëshe, është krijuar, në periudhën 1993-2000, ndërkohë që, po ashtu provohet që, dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicie për të paditurit dhe personat e tretë, që ata janë përfshirë në veprimtari kriminale, sipas këtij ligji, ekziston, vetëm për periudhën, pas vitit 2003, pra, pas krijimit kësaj pasurie dhe për këtë arsye, godina katër katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, nuk mund t’i nënshtrohet konfiskimit, sepse, vetë ligji, në mënyrë të shprehur, e ndalon një gjë të tillë.

**19.** Duke qenë se, për pasurinë e mësipërme, godinë katërkatëshe, objekt i kërkesës për konfiskim, nga ana e akuzës nuk u arrit që të provohej pjesa barrës së proës që, ligji i posaçëm nr. 10 192, datë 3.12.2009, i ngarkon asaj, si dhe nisur edhe nga fakti që, për këtë pasuri, nuk mund të zbatohen dispozitat e këtij ligji, gjykata vlerëson që, të paditurit dhe personat e tretë, çlirohen nga barra e provës për të provuar se, këtë pasuri e kanë vënë në mënyrë të ligjshme. Kjo për faktin që, në vlerësim të kësaj gjykate, barra e provës që kanë palët në bazë të ligjit të posaçëm nr. 10 192, datë 3.12.2009, është e ndërvarur dhe e kushtëzuar, në favor të të paditurit në këtë gjykim.

**20.** Kjo do të thotë që, është akuza që, fillimisht, duhet të provojë që ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie, që i padituri ose/dhe personi i tretë, ka kryer një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 e ligjit në fjalë dhe vetëm, pasi akuza e kalon me sukses pjesën e saj të barrës së provës, i padituri ose personi i tretë, duhet të provojë, pjesën e tij të barrës së provës që, pasuritë objekt konfiskimi, i ka krijuar me të ardhura të ligjshme. Nëse, nga ana e akuzës, nuk provohet, pjesa e saj e barrës së provës, në lidhje me çdo pasuri, për të cilën ajo paraqet kërkesë për konfiskim, i padituri dhe personi i tretë, çlirohet nga pjesa e tij e barrës së provës dhe pasuria për të cilën është paraqitur kërkesa për konfiskim, nuk mund të konfiskohet.

**21.** Bazuar në këtë konkluzion të gjykatës, për pasurinë godina katër katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, meqenëse, ajo nuk mund t’i nënshtrohet konfiskimit, pasi akuza nuk arriti të provojë që ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie, se, ajo është vënë nga të paditurit dhe personat e tretë, si rrjedhojë e kryerjes prej tyre të veprave penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit të posaçëm nr. 10 192, datë 3.12.2009, të gjitha pretendimet e paraqitura nga prokuroja, në diskutimin e saj përfundimtar, në faqen 7-9, të tij, mbi konkluzionet e aktit të ekspertimit vlerësues, për këtë

pasuri, nuk çmohet me vend që të trajtohen nga gjykata, pasi për këtë pasuri, nuk mund të zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe për pasojë, nuk paraqet rëndësi për gjykimin sa ka qenë kostoja e ndërtimit të tij dhe as sesi të paditurit dhe personat e tretë, i kanë siguruar të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie.

**22.** Nga ana tjetër, për pasuritë një apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në emër të të paditurës N.G, blerë me datë 24.8.2005, një lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, në emër të të paditurës N.G, blerë me datë 4.3.2005, si dhe një shumë prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh, në emër të të paditurës N.G, pavarsisht nga fakti që, edhe këto pasuri janë krijuar para hyrjes në fuqi të ligjit, gjykata, bazuar në aktet dhe provat e shqyrtuara, vlerëson që, nga ana e paditësit, konkretisht, organit të akuzës, u arrit që të provohet që, për këto pasuri, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, që të paditurit dhe personat e tretë, t'i kenë vënë, si rrjedhojë e kryerjes së një ose disa prej veprave penale, të parashikuara në pikën 1 të nenit të nenit 3 të ligjit të posaçëm nr. 10 192, datë 3.12.2009 dhe për pasojë këto pasuri, mund t'i nënshtrohen konfiksimit, në qoftë se, të paditurit dhe personat e tretë, nuk provojnë pjesën e barrës së tyre, sipas të cilës, këto pasuri të jenë siguruar nga të ardhura të ligjshme.

**23.** Për këtë arsye, në ngarkim të të paditurve dhe personave të tretë, bie barra e provës për të provuar që këto pasuri, ato i kanë vënë mbi bazën e të ardhurave të ligjshme, si dhe që niveli i të ardhurave të tyre, nuk është dukshëm, në disnivel me pasuritë që ato zotërojnë apo kanë në posedim. Me qëllim që të paditurit dhe personat e tretë të provojnë që kanë patur të ardhura të ligjshme, për të justifikuar pasuritë objekt konfiskimi, mbi kërkesën e tyre, gjykata caktoi një ekspert kontabël, i cili, do të hartonte një akt ekspertimi me shkrim, në të cilën të pasqyroheshin, në mënyrë të qartë, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurve dhe personave të tretë, deri më datë 31.12.2012, e cila ishte edhe data e kërkuar nga organi i akuzës.

**24.** Po ashtu, duke qenë se, nga ana e organit të akuzës, pati pretendime për vlerën reale të apartamentit të banimit prej 121 m<sup>2</sup> dhe të lokalit me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, nga ana e gjykatës, mbi kërkesën e palëve, u caktua edhe një ekspert vlerësues, i cili, do të paraqiste aktin e ekspertimit me shkrim, për vlerën e tregut të këtyre pasurive, në momentin e blerjes së tyre. Vlen të theksohet që, ekspertit vlerësues, mbi bazën e kërkesës së palëve, iu la si detyrë që të vlerësonte edhe vlerën e kostos së ndërtimit të godinës katër katëshe, por duke qenë se, për këtë pasuri, për arsyet e dhëna më lart, nuk gjejnë zbatim dispozitat e ligjit të posaçëm, duke u përjashtuar kjo pasuri nga konfiskimi, pjesa e aktit të ekspertimit, si dhe e shtesës së aktit të ekspertimit, që vlen për vlerën e kësaj pasurie, nuk paraqet interes për gjykimin dhe nuk do të analizohet nga gjykata në këtë vendim.

**25.** Të paditurit dhe personat e tretë, për të provuar që pasuritë objekt konfiskimi i kanë siguruar nga të ardhura të ligjshme, paraqitën para gjykatës, dokumente shkresore të lëshuar në formën e kërkuar nga ligji, me vulë apostile, të cilat ishin vertetime të lëshuara nga sigurimet shoqërore në Itali, që vertetonin të ardhurat e realizuara nga puna e tyre, në vite të ndryshme, vertetime të lëshuara nga drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore, Durrës, shkresë e lëshuar nga Bashkia Durrës, si dhe dokumente të tjera, që provonin sigurimin e të ardhurave prej tyre.



**26.** Mbi bazën e pyetjeve të shtruara nga ana e gjykatës, eksperti kontabël paraqiti aktin e ekspertimit kontabël, të datës 1.12.2016, në bazë të të cilit, totali i të ardhurave të të paditurve dhe personave të tretë, deri më datë 31.12.2012, ishte në shumën 86 649 627 (tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë. Totali i shpenzimeve i të paditurve dhe personave të tretë, deri më datë 31.12.2012, ishte në shumën 48 903 460 (dyzet e tetë milion e nëntëqind e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë. Diferenca ose fitimi neto, për të këtë periudhë, për të paditurit dhe personat e tretë, ishte 37 746 167 (tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

**27.** Pas shqyrtimit të aktit të ekspertimit kontabël në sencë gjyqësore, si dhe pas konstatimit, me të drejtë nga ana e organit të akuzës, por edhe nga ana e gjykatës që, eksperti kontabël nuk kishte llogaritur shpenzimet për jetesë të disa prej anëtarëve të familjes së të paditurve dhe personave të tretë, ekspertit iu la si detyrë që të hartonte një akt ekspertimi shtesë, ku të llogariteshin edhe këto shpenzime dhe pas paraqitjes së Aktit Kontabël Shtesë, rezultoi që totali i shpenzimeve i të paditurve dhe personave të tretë, deri më datë 31.12.2012, ishte në shumën 62 661 074 (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një e shtatëdhjetë e katër) lekë, ndërsa, diferenca ose fitimi, ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të të paditurve dhe personave të tretë, **ishte 23 988 553 (njëzet e tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë dhe kjo është shuma që do të mbajë parasysh gjykata, në llogaritjen e fitimit neto të të paditurve dhe personave të tretë.**

**28.** Nga ana e tij, eksperti vlerësues në aktin e ekspertimit të datës 1.12.2016, arriti në konkluzionin që, vlera e tregut e apartamentit të banimit, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në kohën e blerjes së tij, në vitin 2005, është në shumën 4 594 975 (katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, ndërsa, vlera e tregut e lokalit, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, në kohën e blerjes së tij, në vitin 2005, është 6 181 350 (gjashtëmilion e njëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

**26.** Pas shqyrtimit të këtij akti në seancë gjyqësore, nga ana e akuzës, u pretendua që, vlera e apartamentit të banimit, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe e lokalit, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, të bëhej në bazë të Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008 të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë dhe mbi bazën e këtij pretendimi, gjykata urdhëroi ekspertin vlerësues të bëjë një Akt Ekspertimi Shtesë, ku, vlera e këtyre pasurive të llogaritej, në bazë të akteve normative të sipërcituara dhe në përgjigje të pyetjeve të bëra nga gjykata, eksperti vlerësues, në aktin e ekspertimit shtesë, përcaktoi që, vlera e apartamentit të banimit, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në bazë të Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave është 6 635 398 (gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, ndërsa, vlera e e lokalit, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, në bazë të Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008 të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë ishte, 6 679 268 (gjashtë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

**27.** Në lidhje me vlerësimin e apartamentit të banimit, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe të lokalit, me

sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, gjykata ndodhet para dy vlerësimeve të bëra nga eksperti vlerësues, një vlerësim sipas çmimit të tregut dhe një vlerësim të bërë në bazë të akteve normative të pretenduara nga prokurori. Për këto dy vlerësime, që paraqesin vlera të ndryshme, ku, vlerësimi i bërë nga eksperti në bazë të akteve normative, për të dy pasuritë, ka një vlerë më të madhe, afërsisht në 2 500 000 lekësh, pavarësisht nga pretendimet e mbrojtjes, por edhe kundërshtimet e ekspertit, sipas të cilit, aktet normative, kanë një tjetër qëllim dhe nuk përcaktojnë vlerën e tregut të këtyre pasurive, gjykata do të mbajë në konsideratë vlerën që kanë këto pasuri, në bazë të udhëzimit të Këshillit të Ministrave dhe atij të Ministrit të Financave dhe të Drejtësisë, pasi në çmim të kësaj gjykate, vlera që kanë këto pasuri, në bazë të këtyre akteve normative, është më afër të vertetës.

**28.** Gjukata, çmon të sqarojë që, marrja në konsideratë si vlerë e tregut për pasuritë apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe lokal, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, vlerën që rezulton në bazë të të udhëzimit të Këshillit të Ministrave dhe atij të Ministrit të Financave dhe të Drejtësisë, nuk bëhet prej saj, në mënyrë subjektive dhe arbitrare, por bëhet duke u bazuar në dy argumente shumë të rëndësishme që janë: e para, ashtu siç me të drejtë akuza pretendoi, eksperti nuk arriti që të tregojë se cilët ishin kriteret shkencore që ai kishte përdorur, në nxjerrjen e vlerës së tregut të këtyre pasurive dhe akti i ekspertimit në këtë drejtim ishte më shumë se, i thjeshtë, totalisht, sipërfaqësor dhe jo bindës për gjykatën dhe së dyti, nga aktet normative të mësipërme, përcaktohet vlera e kostos së këtyre ndërtimeve dhe për gjykatën, është jo logjike dhe e papranueshme që, vlera e tregut e një pasurie, të jetë më e ulët se vlera e kostës së saj.

**29.** Në përfundim, duke bërë një balancë të totalit të fitimit neto të të paditurve dhe personave të tretë, i cili, është në shumën 23 988 553 (njëzet e tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, me totalin e pasurive që ata kanë në zotërim dhe për të cilat akuza arriti që të plotësojë, pjesën e vet të barrës së provës dhe që janë apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 635 398 (gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 679 268 (gjashtë milion e gjashtëqind e shtadhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, si dhe shuma e të hollave prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë, rezulton që, totali i pasurisë që kanë të paditurit dhe personat e tretë, i cili, mund të jetë objekt konfiksioni është 14 695 586 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë (apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 635 398 lekë + lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 679 268 lekë + shuma prej 1 380 920 lekë = 14 695 586 lekë).

**30.** Bazuar në të gjitha aktet dhe provat e shqyrtuara, gjykata çmon se, totali i fitimit neto të të paditurve dhe personave të tretë, është dukshëm më i madh se, vlera e pasurive që ato kanë në pronësi ose përdorim dhe që, mund të jenë objekt konfiskimi dhe për këtë arsye, duke qenë se të paditurit dhe personat e tretë, arritën që të provojnë prejardhjen e ligjshme të këtyre pasurive, kërkesa e akuzës për konfiskimin e tyre, nuk është e bazuar në nenin 24, pika 1 e ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, prandaj ajo do të rrëzohet.

**31.** Kjo dispozitë ligjore parashikon:

**“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mësipërme:**

**a) kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;**

**b) kur nuk provohet që pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotëtrimin e pasurive dhe të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe**

**c) kur rezulton që pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit”.**

**32.** Në rastin objekt gjykimi, organi i akuzës, siç është trajtuar, me hollësi, më lart në këtë vendim, arriti të plotësojë barrën e vet të provës, të parashikuara nga germa “a”, e pikës 1 të nenit 24 të ligjit në fjalë, vetëm për pasuritë apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 635 398 lekë, lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 679 268 lekë dhe shumën prej 1 380 920 lekë, pasuri të cilat figuronin të gjitha në emër të të paditurës N.G, ndërsa, për pasurinë godinë katër katëshe, organi i akuzës nuk arriti të përmbushë barrën e vet të provës, pasi kjo pasuri, rezultoi që ishte krijuar nga të paditurit dhe personat e tretë, para hyrjes së në fuqi të këtij ligji, si dhe para se të ekzistonin dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, që të paditurit dhe personat e tretë, të kishin kryer një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009.

**33.** Nga ana tjetër, të paditurit dhe personat e tretë për pasuritë që akuza arriti të provojë barrën e vet të provës dhe që ishin apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 635 398 lekë, lokal me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me vlerë 6 679 268 lekë dhe shumën prej 1 380 920 lekë, arritën të përmbushin të përmbushin pjesën e tyre të barrës së provës, duke provuar që këto pasuri, janë siguruar nga veprimtari dhe të ardhura të tyre të ligjshme dhe në këto kushte, duke qenë se, nuk plotësohet kërkesa ligjore e parashikuar nga germa “b”, e pikës 1 të nenit 24 të ligjit, pasi u provua që këto pasuri kishin prejardhje të ligjshme, kërksa e organit të akuzës, për konfiskimin e këtyre pasurive, do të rrëzohet, pasi është në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore.

**34.** Gjykata e gjen me vend të ndalet dhe të shprehë në këtë vendim, arsyet se, pse, nuk merren parasysh prej saj, pretendimet e tjera të paraqitura nga akuza në diktumin e saj përfundimtar, duke pasqyruar argumentet vetëm për ato pretendime të akuzës për të cilën kjo gjykatë, nuk është shprehur, ende në këtë vendim, pasi për një pjesë të rëndësishme të pretendimeve të akuzës, gjykata, në këtë vendim është shprehur dhe ka sqaruar se, pse ato janë të pabazuara dhe nuk pranohen prej gjykatës.

**35.** Në diskutimin e saj përfundimtar, nga faqja 6, deri në faqen 14 të tij, çka përbën edhe pjesën më të madhe të diskutimit përfundimtar të akuzës, ajo pretendon që, vlerësimet e bëra në akti i ekspertimit vlerësues për të tre pasuritë objekt konfiskimi, ndërtesë katërkatëshe, apartament me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe lokal me sipërfaqe 774 m<sup>2</sup>, janë të pabazuara, pasi konkluzionet e arritura nuk janë objektive dhe nuk pasqyrojnë vlerën reale të këtyre pasurive.

Për këto pretendime, gjykata çmon të theksojë se, pretendimet e akuzës për vlerësimin e ndërtesës katërkatëshe, të ndërtuar në periudhën e viteve 1993-2000, janë të pabazuara, sepse, kjo pasuri është krijuar para se ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, të ketë hyrë në fuqi, si dhe para se, për të paditurit dhe personat e tretë të ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie që kanë kryer një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të këtij ligji dhe përderisa kjo pasuri, nuk përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji dhe nuk mund të jetë objekt i konfiskimit, sipas këtij ligji, çdo pretendim që akuza bën për vlerën e kësaj pasurie, nuk mund të merret parasysh nga gjykata, pasi janë pretendime që bëhen për një pasuri, e cila, nuk mund të konfiskohet dhe ndodhet jashtë fushës së zbatimit të ligjit në fjalë.

**36.** Pretendimet e akuzës për vlerën e dy pasurive të tjera, konkretisht, apartament me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe lokal me sipërfaqe 774 m<sup>2</sup>, çmohen nga gjykata si të bazuara dhe për këtë arsye, vlera e tregut e këtyre pasurive është llogaritur nga gjykata, mbi bazën e kriterëve të kërkuara nga ana e akuzës, konkretisht, mbi bazën e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 23.11.2005, si dhe Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, vlerë e cila, është pasqyruar në Aktin e Ekspertimi Shtesë, por, gjykata çmon të theksojë që, megjithë llogaritjen e këtyre pasurive, sipas këtyre kriterëve të kërkuara nga akuza, të paditurit dhe personat e tretë, e justifikojnë krijimin e këtyre pasurive, me të ardhura të ligjshme të siguruara nga ana e tyre.

**37.** Përsa i përket pretendimeve të bëra nga akuza për aktin e ekspertimit kontabël dhe shtesën e këtij akti, pretendime këto të paraqitura në faqet 14 dhe 15 të diskutimit përfundimtar, gjykata, i çmon ato si të pabazuara dhe prandaj nuk do të merren parasysh prej saj. Akuza pretendon që, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurve dhe personave të tretë, nuk rezultojnë nga burime të qarta, objektive dhe ligjore. Në ndryshim nga sa pretendon akuza, bazuar në konkluzionet e akteve të ekspertimit kontabël, në shpjegimet e ekspertit të bërë në seancë gjyqësore, si dhe në të gjitha aktet dhe provat e shqyrtuara, gjykata vlerëson që shuma prej 23 988 553 (njëzet e tre milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, e cila rezulton si fitim neto i të paditurve dhe personave të tretë, është rrjedhojë e të ardhurave të ligjshme të tyre, të nxjerrë nga puna e tyre në Itali, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme, në Shqipëri, të cilat eksperti kontabël, i ka nxjerrë mbi bazën e dokumenteve të administruara, për çdo vit, për të çdo të paditur dhe person të tretë.

**38.** Për aktet e ekspertimit kontabël (Aktin e datës 1.12.2016 dhe Shtesën e aktit të ekspertimit), akuza pretendon që, vlerat që rezultojnë prej tyre, të mos merren parasysh nga gjykata, sepse, sipas akuzës, eksperti në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve, është bazuar edhe në hamendësime, në llogaritje hipotetike dhe në prezumime të nxjerra nga të dhëna statistikore, të marra në shtetin shqiptar dhe italian. Ky pretendimi i organit të akuzës vlerësohet nga gjykata si i pabazuar, sepse, në kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël, eksperti nuk është bazuar në hamendësime, si dhe nuk ka bërë llogaritje hipotetike apo nuk është bazuar në prezumime të nxjerra nga të dhëna statistikore, por, eksperti, është bazuar vetëm në akte dhe dokumentet e dosjes, siç janë vertetimet për çdo vit të lëshuar nga sigurimet shoqërore, në Itali, për personat e tretë, si dhe në dokumente të tjera ligjore që vertetojnë realizimin e të ardhurave, të lëshuara në Shqipëri.

**39.** Është e vertetë që eksperti në llogaritjen e shpenzimeve për personat e tretë dhe

familjarëve të tyre, në Itali dhe për të paditurit në Shqipëri, në mungesë të dokumentacionit që provonte realizimin e shpenzimeve për jetesë, për çdo subjekt, i është referuar të dhënave statistikore, të përcaktuara nga institucionet komptente, në Itali dhe Shqipëri, por, kjo zgjedhje e bërë nga eksperti, vlerësohet nga gjykata se, është e drejtë, në kushtet kur, eksperti nuk ka patur asnjë mundësi tjetër që të nxjerrë shpenzimet për jetesë, të të paditurve dhe personave të tretë, për periudhën që nga ana e tyre është bërë realizimi i të ardhurave të ligjshme.

**40.** Pretendimi tjetër i akuzës, sipas të cilit nga ana e ekspertit kontabël është pranuar si e ardhur nga depozita, shuma prej 124 472 euro, duke u llogaritur kjo shumë në sasinë e të ardhurave të ligjshme të të paditurve dhe personave të tretë, ndërkohë që, kjo shumë figuron në emër të të paditurës N.G, pa përshkrim të burimit të të ardhurave, vlerësohet të mos merret parasysh nga gjykata, pasi bazuar në shpjegimit e dhëna nga eksperti, në seancë gjyqësore, kjo shumë rezulton të jetë transferuar si rrjedhojë e aktivitetit të ligjshëm që personat e tretë, kanë realizuar në Itali, në periudhën e viteve 1998-2012.

**41.** Pretendimi tjetër i organit të akuzës, ku ajo pretendon që, të paditurit dhe personat e tretë, duhet të provojnë të ardhurat e ligjshme për shumën prej 265 mijë euro, të depozituara në vitet 2009-2011 edhe pse shumë sipas akuzës nuk është sekuestruar dhe nuk është objekt i kërkesës për konfiskim, gjendet nga gjykata si i pabazuar, sepse, tejkalon parimin e disponibilitetit dhe të kontraktidktoritetit, si parime bazë të procesit civil, pasi përderisa akuza, në kërkesën e saj për gjykim, nuk ka kërkuar konfiskimin e kësaj pasurie, ose të ekuivalencës së saj, të paditurit dhe personat e tretë, nuk mund të kanë detyrimin që të provojnë prejardhjen e ligjshme të saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata bazuar në nenet 3, pikat 1; 2 dhe 4, 21, 24, pika 1 të nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

### **VENDOSI:**

**1.** Rrëzimin si të pabazuar në prova e ligj, të kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kundër të paditurve N.G, S.G dhe personave të tretë F.G, I.M, B.M (G) dhe SH.H, me objekt konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

- Ndërtesë katër katëshe, e ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX, me numër pasurie X/XX, e cila ka një sipërfaqe prej 1 810 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 182 m<sup>2</sup> + 44 m<sup>2</sup> + 1 232 m<sup>2</sup>, që është në proces legalizimi, në emër të shtetasit S.G;

- Apartament banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, me numër pasurie XX/XXX+X-XX, vol XX, faqe XXX, zona kadastrale XXXXX Durrës, rregjistruar në emër të shtetasit N.G;

- Lokal, me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup>, me adresë në lagje nr. X, Rr: “XXXX”, me numër pasurie XX/XXX- XX, zona kadastrale XXXX, volumi XX, faqe XXX, në emër të shtetasit N.G;

- Shumë lekësh prej 1 380 920 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet)

lekësh.

2. Heqjen e masës së sekuectros të vendosur me vendimin nr. 23, datë 6.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Një kopje e Vendimit t'i dërgohet Zyrës së Përmbarimit Durrës dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuectruara dhe Konfiskuara.
4. Shpenzimet gjyqësore u ngarkohen palëve siç janë bërë.
5. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
6. U shapall në Tiranë, sot me datë 9.3.2017.

**SEKRETARE**

**OLTA SINANAJ**

**GJYQTARE**

**LILJANA BAKU**









